



Pranimi i Blotimit Dokumentacioni/Pastirato Blotimi/Blotiruvy		14-01-2022		vet shtet qytet
Qajmë e Pajmë Dokumentacioni Dokument	Nr. Punt Dok. No.	Ditëzgj Punt Agjencija	Kategoria Pajmë Dokument	
Shtet/Blotim		169/2022	119	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1186/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1271/2020 të datës 13.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.150/2020 të datës 27.05.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë _____, undër Vendimit me numër Ref.SBNJD-120/20 të datës 28.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike "*masë disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin I nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin I nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.150/2020 e datës 27.05.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me numër Ref.SBNJD-120/20 i datës 28.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Vendimi me numër Ref.SBNJD-83/2020 i datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës.
- III. **Obligohet** Kryeshafi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Udhëheqësi i Personelit i Agjencisë Pyjore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke kthyer ankuesin në vendim e punës sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën "Zyrtar për Çështje Ekonomike" në Drejtorinë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij nga marrëdhënia e punës, të bëjë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në

zbatimin e këtij vendimi si dhe të shuaj masën disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij, në pajtim me këtë vendim dhe dispozitat ligjore në fuqi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit punësuar sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën "Zyrtar për Çështje Ekonomike" në Drejtorinë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan, më datë 18.02.2020 Drejtori i Drejtorisë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan ka paraqitur kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës me arsyetim që nëpunësi ka bërë shkelje ligjore ndaj detyrave të punës si dhe ka shkelur disa herë Kodin e Mirësjelljes në shërbimin civil të Kosovës duke ju shqiptuar tri vërejte me shkrim të njëpasnjëshme nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejt dhe një vërejtje nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 13.03.2020 ka nxjerr Vendim me numër Ref.SBNJD-83/2020 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Ref.SBNJD-83/2020 të datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 16.04.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 28.04.2020 ka nxjerr Vendim me numër Ref.SBNJD-120/20 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 16.04.2020.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër Ref. SBNJD-120/20 të datës 28.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.05.2020 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmshek@rksc.gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër të ankesës A.nr.150/2020 dhe Nr. Prot: 975/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 02.06.2020, ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia Pyjore e Kosovës. Këshilli më datë 11.06.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Pyjore e Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 08.06.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për

arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 13.12.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1271/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 08.06.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 27.05.2020 të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.05.2020 me numër protokollit 975/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 27.05.2020 të ankuesit për ankesa.kpmshek@rks-gov.net; Ftesën për seancës e parë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 21.04.2020; Njoftim për inicim të procedurës disiplinore dhe procedim të rastit të komision disiplinor i datës 21.02.2020 për ankuesin; Procedimin e lëndës disiplinore për shqyrtim në Komisionin Disiplinor i datës 19.02.2020; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 18.02.2020; Procesverbalin e datës 23.04.2020 dhe 04.03.2020 të seancës së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër Ref:SBNJD-120/20 i datës 28.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i APK-së; Vendimin me numër Ref:SBNJD-83/2020 i datës 13.03.2021 i protokolluar më datë 18.03.2020 i Komisionit Disiplinor i APK-së; Vërejtjen me shkrim të datës 05.07.2019; Vërejtjen me shkrim të datës 15.08.2019; Vërejtjen me shkrim të datës 13.02.2020; Vërejtjen me shkrim të datës 12.02.2020; Dërgimi i raporteve për muajin korrik 2019 nga ankuesi; Dërgimi i pasqyrës për OE, shfrytëzim të përkohshëm të tokës, pyjore me qira për periudhën janar-tetor 19 i datës 30.11.2019; Dërgimi i raporteve për muajin nëntor 2019 i datës 20.12.2019; Dërgimi i raporteve të hyrave për muajin nëntor 2019 i datës 13.12.2019; Dërgimi i raportit për muajin tetor 2019 i datës 11.11.2019; Dërgimi i pasqyrës për OE, shfrytëzim të përkohshëm të tokës, pyjore me qira për periudhën janar-korrik 2019 i datës 30.08.2019; Kërkesë për raportim në APK qendër e datës 14.01.2020 për ankuesin; Shkresë për të hyrat e paraportuara dhjetor 2019; Raporti javor i punës nga data 25.11.-29.11.2019 nga ankuesi; Raporti javor i punës nga data 18.11.-22.11.2019 nga ankuesi; Raporti javor i punës nga data 11.11.-15.11.2019 nga ankuesi; Raporti javor i punës nga data 09.12.-13.12.2019 nga ankuesi; Raporti javor i punës nga data 13.05.-17.05.2019 nga ankuesi; Kërkesë për dorëzimin e raporteve mujore qershor 2019 për ankuesin; Ankesën e datës 09.03.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vërejtjes së datës 12.02.2020; Ankesën e datës 12.03.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vërejtjes së datës 13.02.2020; Ankesën e datës 16.04.2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së; Deklaratën mbi njoftimin e pranuar përmes emailit të datës 21.02.2020 të bërë më datë 24.02.2020; Deklaratën mbi njoftimin e pranuar përmes emailit të datës 02.03.2020 të bërë më datë 02.03.2020; Deklaratën mbi njoftimin e pranuar përmes emailit të datës 25.02.2020 të bërë më datë 25.02.2020; Kërkesën për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor e datës 04.03.2020 nga ankuesi; Deklaratën e datës 05.03.2020 të ankuesit; Emailin e datës 05.03.2020 nga ankuesi për Emailin e datës 05.03.2020 nga për

ankuesin; Njoftimin e datës 06.03.2020 të ankuesit; Kërkesën e ripërsëritur për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor e datës 09.03.2020; Kërkesën për shqyrtim të adresimeve që Komisioni Disiplinor të jetë nga MBPZH e datës 16.03.2020 nga ankuesi; Akt Emërimit e datës 31.01.2012 në emër të ankuesit; Vërtetimin e datës 11.06.2015 në emër të ankuesit; Njoftim për së dyti i datës 13.02.2020 nga ankuesi; Njoftim i datës 01.11.2019 nga ankuesi; Ankesën e datës 01.11.2019 nga ankuesi; Kërkesën e datës 15.10.2018 nga ankuesi; Vendimin e datës 17.11.2016; Përgjigje në kërkesë e datës 28.10.2016; Kërkesën e datës 29.05.2019 nga ankuesi; Kërkesën e datës 24.07.2019 nga ankuesin; Deklaratën e punëdhënësit; Emaili i datës 29.03.2018 nga ankuesi; Referencën e datës 10.08.2018; Letër Rekomandimin e datës 18.01.2018; Emailin e datës 02.11.2016 nga ankuesi për A.Z; Kërkesën e datës 02.11.2016 nga ankuesi; Njoftimin e datës 25.10.2019 nga ankuesi; Kërkesën e datës 25.10.2019 nga ankuesi; Njoftimin e datës 04.07.2019 të ankuesit; Njoftimin e datës 14.01.2019 të ankuesit; Deklaratën e datës 01.08.2019; Njoftimin e datës 16.10.2019; Njoftimin e datës 01.10.2018; Ankesën e datës 05.06.2019 nga ankuesi; Emailin e datës 07.06.2019 nga ankuesi për D.G; Emailin e datës 06.06.2019 na D.G për ankuesin; Njoftimin e datës 25.08.2017 të ankuesit; Kërkesa e datës 24.03.2011; Njoftimin e datës 15.10.2010; Kërkesë për një takim pune me drejtorin e datës 04.07.2011 nga ankuesi; Njoftimin e datës 18.06.2019; Deklaratën lidhur me parregullsitë e hasura në formularin e evidencës së ardhjes në punë e datës 31.12.2010; Vërejtje e datës 04.07.2011; Formularin e evidencës së ardhjes në punë 2010; Emailin e datës 04.10.2019 nga ankuesi për B.Rr; Njoftimin e datës 27.08.2010; Kërkesë-Propozim i datës 14.01.2020 të ankuesit; Vendimin e datës 20.05.2013 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje me shkrim e datës 08.02.2013; Ankesë e datës 08.02.2012 e ankuesit; Kërkesën e datës 21.01.2014 e ankuesit; Emailin e datës 20.12.2019, 04.12.2019, 11.01.2020, 08.01.2020 nga ankuesi për M.S; Emailin e datës 09.10.2020, 08.01.2020 nga M.S për ankuesin; Emailin e datës 08.01.2020 nga N.T; Listë distribuimi me titull raporti javor i punës 23.04, 18-27.04; Deklaratën e datës 14.02.2018 e ankuesit; Kërkesën e datës 14.08.2019 të ankuesit; Njoftimin e datës 24.04.2020 nga ankuesi; Kërkesë e datës 04.05.2020 e ankuesit; Kërkesën e datës 24.04.2020 e ankuesit; Ankesë e datës 24.04.2020 e ankuesit; Kërkesën e datës 30.09.2019, 24.09.2019 të ankuesit; Njoftimin e datës 16.10.2019 të ankuesit; Emailin e datës 13.09.2019 nga ankuesi për B.Rr; Kërkesën për deklaratë e datës 17.09.2019; Kërkesën e ankuesit e datës 21.07.2020 për KPMSHCK; Kërkesën e datës 23.05.2020 nga ankuesi për KPMSHCK; Kërkesën e datës 30.10.2020 të ankuesit për KPMSHCK për bashkimin e pesë ankesave; Kërkesën e datës 18.11.2020 të ankuesit për KPMSHCK; Kërkesën e datës 22.01.2021, 01.12.2020, 14.10.2020 e ankuesit për KPMSHCK; Përgjigjen e datës 02.12.2020 për ankuesin nga KPMSHCK; Njoftimin e datës 08.06.2020 nga KPMSHCK për ankuesin; Kërkesën e datës 22.10.2020 nga Kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Perona të Pagjetur dhe Peticione; Kërkesën e datës 22.12.2021 nga ankuesi për KPMSHCK; Provë e datës 24.12.2021 nga ankuesi për KPMSHCK; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2020; Përgjigjen në ankesë e datës 11.06.2020 nga Agjencia Pyjore e Kosovës; Formulari për planin individual të punës për periudhën janar-dhjetor 2019 i datës 26.12.2018; Emailin e datës 09.02.2020 nga B.Rr për ankuesin; Emailin e datës 09.02.2020 nga ankuesi; Emailin e datës 05.02.2020 nga ankuesi për Z., dhe B.S; Emailin e datës 16.01.2020 nga B.Z për B.S; Emailin e datës 13.02.2020 nga A.Z për ankuesin; Raport pune nga vizita monitoruese e datës 03.07.2019 në DKR të APK-së në Gjilan datë 04.07.2019; Shkresë për informim e datës 18.02.2020; Shënim Zyrtar-kërcënimet nga R.H e datës 30.04.2018 nga B.Rr; Ankesë e datës 27.10.2009; Shkresë për informim e datës 14.02.2020; Kërkesë për përmirësim e datës 10.12.2019; Procesverbalin e scancës së Komisionit Disiplinor i datës 04.03.2020, 06.03.2020, 11.03.2020, 13.03.2020; Procesverbalin e scancës së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës

23.04.2020; Njoftimin lidhur me dërgimin e raporteve në afatin e caktuar i datës 10.01.2019; Emaili i datës 10.01.2020 për ankuesin nga B.Rr; Kërkesë për raportime mujore dhe periodike sipas afatit e datës 06.02.2020; Kërkesë urgjente për raportim e datës 17.01.2020; Emailin e datës 13.12.2019 dhe 12.12.2019 nga B.Rr për ankuesin; Emailin e datës 16.10.2020 nga M.S për ankuesin; Emailin e datës 13.01.2020 nga M.S për ankuesin; Emailin e datës 15.10.2019 nga M.S për ankuesin; Emailin e datës 05.02.2020 nga S.Sh për ankuesin; Emailin e datës 05.02.2020 nga ankuesi për S.SH; Kërkesën e datës 04.02.2020; Njoftimin për shkele të rregullores për Orarin e punës e datës 10.02.2020 për ankuesin; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Çështje Ekonomike; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 i datës 24.12.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 27.12.2019; Ftesën për seancë të Komisionit Disiplinor e datës 02.03.2020 dhe 09.03.2020 dhe Aktgjykimin A.nr.1271/2020 të datës 13.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruar përmes ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili pretendon se Vendimi me numër Ref.SBNJD-83/2020 i datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës me të cilin i është ndërprere marrëdhënia e punës është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë procedurat disiplinore në shërbimin civil, po ashtu Vendimi me numër Ref.SBNJD-120/20 i datës 28.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në të gjitha provat e lëndës, kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 18.02.2020 nga udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit është bërë mbi pretendimet që ankuesi ka bërë shkelje ligjore ndaj detyrave të punës si dhe ka shkelur disa herë Kodin e Mirësjelljes në shërbimin civil të Kosovës duke ju shqiptuar tri vërejte me shkrim të njëpasnjëshme nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejt dhe një vërejte nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pretendimet për iniciimin e procedurës disiplinore mbi bazë të vërejtjeve me shkrim të shqiptuar në mënyre të njëpasnjëshme ndaj ankuesit brenda vitit 2019 dhe 2020 çoftë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt çoftë nga udhëheqësi më i lartë administrativ, janë pretendime të paqëndrueshme sepse, lidhur me vërejtjet me shkrim të shqiptuara ndaj ankuesit, respektivisht ankuesi për Vërejtjen me shkrim të datës 05.07.2019 më datë 30.09.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për Vërejtjen me shkrim të datës 15.08.2019 ankuesi më datë 01.11.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për Vërejtjen me shkrim të datës 13.02.2020 ankuesit më datë 12.03.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ndërsa për Vërejtjen me shkrim të datës 12.02.2020 ankuesit më datë 09.03.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në bazë të evidencës që posedon Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për ankesat e ankuesit lidhur me vërejtjet e lartcekura, është vendosur vetëm për ankesën ndaj vërejtjes më shkrim të datës 05.07.2019, në bazë të Vendimit A.nr.191/2021 të datës 07.04.2021 të Këshillit të

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse në kohën kur ankuesi ka parashtruar ankesat e tij, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka qenë jo funksional (nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020), mbi bazë të kësaj për tri vërejtjet e tjera edhe pse të njëjtat janë shqiptuar ndaj ankuesit nuk ka vendim përfundimtar me të cilën do të vërtetohej se të njëjtat a janë shqiptuar në pajtim me legjislacion në fuqi apo jo, kështu që pretendimi për iniciimin e procedurës disiplinore mbi bazë të këtyre vërejtjeve pa marr ende vendim përfundimtar në procedurë administrative është veprim i ngutshëm dhe paragjykes.

Lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit në pikën 1 të kërkesës së datës 18.02.2020 për moskryerje të detyrave të punës nga ankuesi, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës, respektivisht në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të datës 24.12.2018 dhe formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 të datës 27.12.2019, ka konstatuar që ankuesi për punët e tij të përcaktuar me përshkrimin e detyrave të punës, nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë për vitin 2018 është vlerësuar me notë të përgjithshme 4.13, që nënkupton se përveç që ka arritur të gjitha objektivat e punës ka treguar aftësi dhe cilësi të punës, duke tejkaluar pritjet, dhe duke kontribuar në realizimin e objektivave të njësisë organizative siç parashihet me nenin 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Kuptimi i notave në paragrafin 2 të këtij neni është si në vijim: "shumë mirë" vlerësohen nëpunësit civil, të cilët jo vetëm i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon pritjet, kanë kontribuar në realizimin e objektivave të njësisë organizative"*, po ashtu ankuesi nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë për vitin 2019 është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.86, që nënkupton *"mirë"* sipas nenit 7 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, kështu që edhe për këtë vit ankuesi ka arritur të gjitha objektivat e punës siç parashihet me nenin 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Kuptimi i notave në paragrafin 2 të këtij neni është si në vijim: "mirë", vlerësohen nëpunësit civil, të cilët i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve) dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi të pritshme"*, Andaj sipas vlerësimit të Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pretendimi i iniciuesit të procedurës disiplinore për moskryerje të detyrave të punës nga ana e ankuesit është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sa i përket pikës dy (2) të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore për tejkallim të kompetencave dhe autorizimeve, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kërkesës, konstaton se pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore ngritën bazuar në Njoftimin e datës 05.02.2010, Kërkesën për caktimin e rojës së natës e datës 09.02.2020, Njoftimin e datës 13.08.2019, Shkresën e datës 16.01.2020, Kërkesë e datës 21.02.2019, Shkresën e datës 13.02.2020 dhe Raportin e punës nga vizita monitoruese i datës 04.07.2019. Bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se për të gjitha pretendimet e supozuara për shkelje të rënda disiplinore nga nëpunësi civil, iniciimi i procedurës disiplinore bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejt konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej 2 ditëve punë do ta paraqes rastin me shkrim te udhëheqësi i njësisë personelit"*, në rastin konkret të ankuesit nuk janë respektuar këto afate.

Lidhur me pretendimet në pikën tre (3) të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 18.02.2020, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të kësaj pretendimet janë ngritur mbi bazën e shkresave të datës 04.10.2019 dhe 04.12.2019, rrjedhimisht në bazë të kësaj me rastin e iniciimit të procedurës disiplinore për këtë rast nuk janë respektuar afatet ligjore të përcaktuara me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejt konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelej e rëndë-serioze, në afat prej 2 ditëve punë do ta paraqes rastin me shkrim te udhëheqësi i njësisë personelit"*.

Po ashtu pika katër (4) e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit është ngritur mbi bazën e shkresës së datës 28.01.2020, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se edhe për këtë pikë nuk janë respektuar afatet ligjore të përcaktuara me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejt konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej 2 ditëve pune do ta paraqes rastin me shkrim te udhëheqësi i njësisë personelit"*.

Sa i përket pikës së pestë (5) të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e cila bazohet në shkresën e datës 18.02.2020 të asistentit administrativ të APK-së në Gjilan, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se shkresa e asistentit të APK-së në Gjilan është e datës 14.02.2018 në bazë të të cilës pretendohet që ankuesi nuk ka sjellje të mira me kolegët dhe palët e tjera, mirëpo në bazë të provave të lëndës kjo shkresë është e pamjaftueshme për rastin në fjalë sepse nuk janë bashkangjitur dëshmi të tjera me të cilat vërtetohet se ankuesit ka pasur sjellje jo korrekte me palët e tjera, po ashtu iniciuesi i procedurës disiplinore përdor dëshmi të datës 30.04.2018 me rastin e iniciimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, në këtë rast iniciuesi i procedurës disiplinore para se të marr veprime konkrete që para iniciimit të procedurës disiplinore të takohet me ankuesin siç parashihet me nenin 11 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, po ashtu dëshmitë e vitit 2018 respektivisht shkresa e datës 30.04.2018 për këtë rast është dëshmi jo relevante për faktin që procedura disiplinore nuk mund të iniciohet për pretendime që kanë ndodhur dy vite më herët, sepse Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, nuk parasheh iniciim të procedurës disiplinore në mënyrë retroaktive.

Bazuar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 18.02.2020, udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit nuk ka pretendimet ndaj ankuesit për ngacmim seksual ndaj ndonjë zyrtari të Agjencisë Pyjore të Kosovës, mirëpo vetëm i ka përshkruar si dëshmi deklaratën e datës 18.02.2020 dhe 27.10.2009 të mirëmbajtëses L.H.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref.SBNJD-83/2020 të datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020, nuk ka arritur të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, respektivisht pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore, po ashtu tek rastin i ngacmimit seksual siç pretendohet komisioni disiplinor ka dhënë konstatime duke mos qenë pretendime të iniciuesit të procedurës disiplinore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kompetencat e Komisionit Disiplinor janë përcaktuara me Rregullore Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil konkretisht nenin 13, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të shqyrtoj saktë provat e lëndës gjegjësisht nuk ka arritur të konstatoj nëse iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë mbi bazën e provave relevante dhe nuk ka arritur të konstatoj nëse iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë brenda afateve ligjore. Po ashtu Komisioni Disiplinor i Agjencisë Pyjore të Kosovës në rastin konkret të ankuesit kur ka konstatuar se ka pasur ngacmim seksual nga ankuesi ndaj L.H, si provë i'u është referuar ankesës së datës 27.10.2009 e përsëritur përmes shkresës për informim të datës 18.02.2020 të mirëmbajtëses së APK-së në Gjilan L.H, mirëpo nuk ka konstatuar saktë që a qëndrojnë këto pretendime që a ka pasur apo jo ngacmim seksual, sepse në bazë të këtyre shkresave nuk konstatohet askund që ka pasur ndonjë ngacmim seksual, po ashtu Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoj se për cilat arsye këto pretendime nuk janë iniciuar që nga vitit 2009 por të njëjtat janë iniciuar vetëm në ditën kur është bërë edhe kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore.

Bazuar në këto, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat dhe po ashtu në provat e lëndës, ka konstatuar që masa disiplinore *"ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension"* shqiptuar ndaj ankuesit nuk është në pajtim me nenin 66 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunësit civil"* dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, sepse Komisioni Disiplinor i Agjencisë Pyjore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref.SBNJD-83/2020 të datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e 45, 63, 64, 65, 66 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3, nenin 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.5, 1.10, 1.13, 1.20, 1.21 dhe 1.22, nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 11 paragrafi 1, nenin 12 paragrafi 1, nenin 13 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Po ashtu Vendimi me numër Ref.SBNJD-83/2020 i datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.4, paragrafin 2, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.5 dhe 1.6, kështu që pretendimet ankimore që Vendimi me numër Ref.SBNJD-83/2020 i datës 13.03.2020 i protokolluar më datë 18.03.2020 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref.SBNJD-120/20 i datës 28.04.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, kështu që pretendimi i ankuesit se Vendimi me numër Ref.SBNJD-120/20 i datës 28.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, është i kundërligjshëm, është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Udhëheqësi i Personelit i Agjencisë Pyjore të Kosovës janë të obliguar që ankuesin ta kthejnë në vendim e punës sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën "Zyrtar për Çështje Ekonomike" në Drejtorinë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Gjilan, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij nga marrëdhënia e punës, të bëjë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi si dhe të shuaj masën disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij, në pajtim me këtë vendim dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të fëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1186/2021

Avdyl BEKTESHI
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Z.

Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje

Administrative;

- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.